



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.516/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Driton Gërxhaliu kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Vushtrri nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur përshkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa Driton Gërxhaliu kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Vushtrri nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur përshkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 25.10.2014, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 23.10.2017 nga Driton Gërxhaliu kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Vushtrri nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) i cili pretendon se me datën 22.10.2017 në qendrën e votimit 2702B/03R dhe 05D në shkollën Ali Kelmendi në vendvotimet e kësaj qendre të votimit dyshon të kenë devijuar rezultatet e numërimit të votave.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimet 2702B/03R dhe 05D në shkollën Ali Kelmendi, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatit të votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Driton Gërxhaliu, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.516/2017 më datën 25.10.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.